



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 11, datë 02.02.2018

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“REHABILITIMI I INSTITUTIT TË STUDIMEVE TË TEKNOLOGJISË SË**  
**NDËRTIMIT (ISTN)”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Agjencisë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rehabilitimi i Institutit të Studimeve të Teknologjisë së Ndërtimit (ISTN)”, me subjekt zhvillues Agjencinë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**EDI RAMA**



**MINISTËR I LINJËS**  
**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
**DAMIAN GJIKNURI**



**ANËTAR / SEKRETAR I KKT**  
**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

